



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

i mbledhjes së dytë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 31.3.2026, e cila filloi në orën 10:20.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina (Lidhja për Prishtinën) kryesues i Kuvendit, Bujar Gashi (LDK), Bekim Gashi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Fadil Aliu (LDK), Egzon Pacolli (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Etnik Mustafa (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi-Osmani (LDK), Rifadije Sopi (LDK), Amir Simnica (LDK), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Agron Canolli (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Besianë Musmurati (PDK), Ilirik Musliu (PDK), Yll Muriqi (PDK), Granit Geci (PDK), Plator Gërdovci (PDK), Florian Beka (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fjolla Vukshinaj-Reçica (PDK), Trim Sylja (PDK), Mrika Limani-Myrtaj (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Jeta Dida-Bujari (LVV), Berita Abazi-Muhadri (LVV), Çlirim Gërbeshi (LVV), Feim Osmani (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Nexhmije Gjema (LVV), Lumniye Mikullovc (LVV), Leonora Shabani-Bajraktari (LVV), Enver Redenica (LVV), Kreshnik Smajlaj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Erblina Tahiraj (AAK), Yll Bogaj (AAK), Betim Abdullahu (Lidhja e Prishtinës), Arbentia Murseli-Haxholli (Lidhja e Prishtinës), Teuta Kadiu-Gjinolli (Lidhja e Prishtinës), Besa Shahini (PSD), Jeton Mehmeti (GUXO), Valbona Ajeti (AAK).

Munguan: Endrit Zabërgja (NISMA).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama – kryetar i Kryeqytetit, Shkëmb Manaj - nënkryetar i komunës, Valbona Makolli - drejtore e Drejtorisë së Financave, Arbër Sadiki - drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Florent Maliqi – drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit, Gëzim Kastrati - drejtor i Drejtorisë së Transformimit, Gent Begolli – drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Donika Çetta – drejtore e Drejtorisë së Parqeve, Luftar Braha - drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Izet Sadiku - drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Donat Lushaku – drejtor i Drejtorisë së Mobilitetit, Samir Shahini – drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Adelina Sahiti - drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Rrezarta Aliu - drejtore e Drejtorisë së Turizimit, Driton Bardheci - drejtor i Drejtorisë së Administratës, Donat Gashi – drejtor i Drejtorisë së Rinisë, Bekim Brestovci - drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, Kushtrim Mushica - drejtor i Drejtorisë së Sportit, Sokol Havolli, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale, përfaqësues të OSBE-së dhe të mediave.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi: Fehmi Kupina- kryesues i Kuvendit, i cili hapi diskutimin rreth pikave të rendit të ditës.

Kushtim Mushica: - Kërkoj sqarim nga zyra e Kuvendit, pasi në vendimet e dërguara mungon kodi buxhetor nga i cili parashihet mbështetja e klubeve, dhe sqaroi se kodi buxhetor për sportin është 85086 dhe nga ky kod pritet të bëhen ekzekutimet në rast të mbështetjes.

Gëzim Sveçla: - në emër të Lëvizjes Vetëvendosje propozoj dy pika për rendin e ditës: pika e parë, diskutim mbi situatën e krijuar me mbeturinat në kryeqytet, dhe pika e dytë, informatë mbi rastin e shembjes së rrugës në lagjen “Prishtina e Re”, me qëllim që të informohemi nga ekzekutivi për zhvillimet.

Kreshnik Smajlaj:- propozoi që në rend dite të futet pika: Propozim-vendimi për subvencionimin e klubit të futbollit “FC Mabetex Prishtina” me vlerë 20,000.00 € (njëzetë mijë euro).

Arbenita Murseli: - propozoi që në rend dite të futet pika: Propozim-vendimi për subvencionimin e klubit të hendbollit femrat “Prishtina” me vlerë 30,000.00 € (tridhjetë mijë euro).

Nexhmije Gjema: - propozoi që në rend dite të futet dy pika: pika e parë, ndalimi i qarkullimit të mjeteve bujqësore në kryeqytet, dhe pika e dytë, mbyllja e të gjitha vendpunishteve në kryeqytet, të cilat më pas i tërheq dhe i lënë për diskutim në pikën e rendit të ditës pyetje dhe përgjigje.

Arbër Sadiki - drejtor: - propozoi që në rend dite të futen dy pika: Pika e parë, propozim-vendim për plotësim ndryshim të PRR Muhaxhirët, Blloku d-01 për nevojat e Fakultetit të Arkitekturës dhe pika e dytë, propozim-vendim për ndërrim të destinimit nga banim individual në institucion arsimor privat në kuadër të planit rregullues të hollësishëm Mati 3.

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e dhëna.

Kryesuesi konstatoi se, më 15 vota për, 31 kundër, nuk u miratua propozimi i parë i z. Sveçla.

Kryesuesi konstatoi se, më 15 vota për, 32 kundër, nuk u miratua propozimi i dytë i z. Sveçla.

Kryesuesi konstatoi se, më 34 vota për, 1 kundër, u miratua propozimi i z. Smajlaj.

Kryesuesi konstatoi se, më 34 vota për, 1 kundër, u miratua propozimi i zonjës Murseli.

Kryesuesi konstatoi se, më 31 vota për, 15 kundër, u miratua propozimi i z. Sadiki-drejtor.

Kryesuesi konstatoi se, më 35 vota për, 12 kundër, u miratua propozimi i z. Sadiki-drejtor.

Me ndryshime dhe plotësime, kryesuesi konstatoi se, më 31 vota për, 12 kundër u miratua ky:

Rend dite:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të seancës së jashtëzakonshme dhe të seancës së parë të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Propozim-vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete;
3. Propozim-vendimi për emërimin e delegatëve për Kolegjin e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK);
4. Propozim-vendimi lidhur me Planin e veprimit për shërbime sociale në kryeqytet 2026-2028;
5. Plani vjetor i punës së Kuvendit të kryeqytetit për vitin 2026;
6. Propozim-vendimi për subvencionimin e “Klubit të Basketbollit të Femrave Prishtina”, KBF Prishtina;
7. Propozim - vendimi për subvencionimin e “Klubit të Volejbollit - Prishtina”;
8. Propozim - vendimi për subvencionimin e “Klubit të Basketbollit Sigal Prishtina”;
9. Propozim - vendimi për subvencionimin e “FC Prishtina 01 - futsal”;
10. Propozim - vendimi për subvencionimin e “K.V Prishtina 75”;
11. Propozim - vendimi për subvencionimin e “3x3 Prishtina”;
12. Propozim - vendimi për subvencionimin e “KH Prishtina”;
13. Propozim-vendimi për subvencionimin e “FC Futsall Mabetex Prishtina”;
14. Propozim-vendimi për subvencionimin e “Kubit të Hendbollit Prishtina femrat”;
15. Propozim-vendimi për vënie në diskutim publik për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores, 01. nr. 110 -2782, më 2.12.2011, për tarifa ngarkesa dhe gjoba komunale;
16. Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 tetor – 31 dhjetor 2025 (TM4);
17. Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2025;
18. Propozim-vendimi për plotësim ndryshim të PRR Muhaxhirët, Blloku d-01 për nevojat e Fakultetit të Arkitekturës;
19. Propozim-vendim për ndërrim të destinimit nga banim individual në institucion arsimor privat në kuadër të planit rregullues të hollësishëm Mati 3;
20. Pyetje dhe përgjigje;
21. Të ndryshme.

Pika e parë:

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të seancës së jashtëzakonshme dhe të seancës së parë të Kuvendit të Kryeqytetit;

Kryesuesi konstatoi se, më 43 vota për, u miratua ekstrakti i procesverbalit të seancës së jashtëzakonshme dhe të seancës së parë të Kuvendit të Kryeqytetit.

Pika e dytë:

Propozim-vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete;

Kryesuesi: - sqaron se Komitetit për Komunitete zgjidhet në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe akteve komunale. Janë propozuar gjashtë anëtarë nga komunitetet joshumicë (serb, ashkali,

boshnjak, goran, rom dhe turk), të cilët janë nominuar nga vetë komunitetet përkatëse. Meqë komiteti duhet të ketë gjithsej 9 anëtarë, tre të tjerë do të propozohen nga radhët e asamblistëve të Kuvendit. Procesi kalon në fazën e propozimeve nga grupet parlamentare dhe hapet diskutimi.

Egzon Pacolli nga LDK-ja - propozoi **Lindita Rexhepi- Osmani**, për anëtare.

Gëzim Sveçla nga LVV-ja - propozoi **Feim Osmani**, për anëtar.

Teuta Kadiu - Gjinolli nga Lidhja e Prishtinës - propozoi **Betim Abdullahu** për anëtar.

Kryesuesi konstatoi se, më 43 vota për, u miratua **Vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete**.

Pika e tretë:

Propozim-vendimi për emërimin e delegatëve për Kolegjin e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK);

Egzon Pacolli nga LDK-ja - propozoi **Pëllumb Bajçinovci** për anëtar.

Leutrim Retkoceri nga PDK-ja - propozoi **Florian Beka** për anëtar.

Mirika Limani nga LVV-ja - propozoi **Gëzim Sveçla** për anëtar.

Teuta Kadiu - Gjinolli nga Lidhja e Prishtinës - propozoi **Betim Abdullahu** për anëtar.

Kryesuesi propozoi - **Besa Shahini** nga PSD për anëtare.

Kryesuesi konstatoi se, më 45 vota për, u miratua **Vendimi për emërimin e delegatëve për Kolegjin e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK)**.

Pika e katërt:

Propozim-vendimi lidhur me Planin e veprimit për shërbime sociale në Kryeqytet 2026-2028;

Lidhur me këtë propozim-vendim të pranishmit në pika të shkurtra i informoi **Adelina Sahiti-drejtoreshë**, ku pas një debati të gjatë në mes të asamblistëve dhe drejtoreshës, kësaj të fundit ju dhanë disa rekomandime që të përfshihen në këtë propozim-vendim dhe drejtoresha e tërheq pikën e katërt nga rendi i ditës.

Pika e pestë:

Plani vjetor i punës së Kuvendit të Kryeqytetit për vitin 2026;

Kryesuesi konstatoi se, më 32 vota për, u miratua **Plani vjetor i punës së Kuvendit të Kryeqytetit për vitin 2026**.

Pika e gjashtë:

Propozim - vendimi për subvencionimin e "Klubit të Basketbollit të Femrave Prishtina" (KBF Prishtina);

Betim Abdullahu: - tha se të gjitha propozimet lidhen me subvencionimin e klubeve të kryeqytetit dhe ai sugjeron që për efikasitet të lexohen vetëm emrat dhe shumat përkatëse, pasi asamblastët tashmë janë të informuar për përmbajtjen, dhe theksoi se propozimet ose do të votohen pro, ose do të refuzohen.

Jeta Rafuna: - propozohet që pikat për subvencione të paraqiten dhe mbrohen të gjitha së bashku, ndërsa votimi të bëhet ashtu siç parashihet edhe me rregullore një nga një.

Arsyeshmërinë për miratimin e këtyre propozim-vendimeve e paraqiti **Kushtrim Mushica- drejtor.**

Pëllumb Bajçinovci: - grupi mbështetë propozimet për subvencione dhe zhvillimin e klubeve sportive në kryeqytet. Ai propozoi që njëherë të përfundojnë subvencionimet për klubet elitare për vitin 2025 të cilat janë përzgjedhur nga komisioni, pastaj me pjesën e mbetur të buxhetit të vazhdohet me klubet e propozuara, duke siguruar një shpërndarje më të drejtë dhe të organizuar të mjeteve.

Leutrim Retkoceri: - tha se propozimet për subvencionimin e klubeve sportive janë shqyrtuar paraprakisht në Komitetin për Politikë dhe Financa, duke u bazuar në një rregullore ekzistuese që përcakton procedurat, ku sipas kësaj rregullore, klubet që përfitojnë deri në 20,000 euro nuk kanë nevojë të kalojnë për votim në Kuvendin Komunal, ndërsa ato klube që kalojnë shumën 20,000 euro trajtohen përmes një thirrje publike dhe rekomandohen nga komisioni përkatës për votim. Theksohet rëndësia që të gjitha mjetet dhe procedurat të jenë në përputhje me ligjin. Ai deklaroi se grupi i PDK-së e përkrah subvencionimin e klubeve sportive të cilat kontribuojnë në zhvillimin e sportit në përgjithësi në kryeqytetin e Prishtinës.

Nora Kelmendi: - foli në emër të grupit të Lëvizjes Vetëvendosje, ku theksoi se qëndrimi mbetet i pandryshueshëm prej vitesh kundër ndarjes së subvencioneve që anashkalojnë procedurat ligjore dhe dëmton besimin e qytetarëve në institucionet publike. Ajo tha se çështja aktuale lidhet me interpretimin e rregulloreve për financimin publik dhe ndarjen e subvencioneve, për të cilat pretendoi se po shkelen nga vetë Komuna e Prishtinës. Nora ngritë shqetësime për mungesë transparence, mosrespektim të afateve ligjore dhe kthimin e një procesi profesional në vendimmarrje politike, duke rikthyer për miratim në Kuvend, çështje që sipas procedurave konsiderohen të përfunduara administrativisht. Ajo kërkoi sqarime konkrete nga Kabineti dhe zyra ligjore lidhur me bazën ligjore të këtyre veprimeve, rolin e komisionit vlerësues dhe arsyet e përfshirjes së Kuvendit në këtë fazë, gjithashtu shtroi pyetje për aspektet buxhetore dhe ligjshmërinë e ndarjes së mjeteve. Ajo ritheksoi se mbështetja për sportin dhe klubet sportive do të vazhdojë, por vetëm nëse subvencionimi bëhet në mënyrë të rregullt, transparente dhe në përputhje të plotë me ligjin.

Gëzim Sveçla: - theksoi se subvencionimet në fjalë janë përsëritur dhe kanë qenë objekt i vërejtjeve nga auditori, madje edhe janë shpallur të paligjshme nga ministria në vitin e kaluar, por megjithatë janë ekzekutuar dhe aktualisht janë nën hetime nga organet përkatëse. Ai kritikoi qasjen e ekzekutivit, duke e cilësuar si të motivuar nga interesat politike dhe jo nga mbështetja reale për sportin sepse mungon një rregullore e mirëfilltë dhe funksionale për mbështetjen e klubeve sportive, ndonëse ka pasur kohë të mjaftueshme për hartimin e saj. Sveçla po ashtu, kundërshtoi rolin e komisionit, duke e theksuar se ai nuk ka mandat për të bërë rekomandime për Kuvendin, por vetëm për të vlerësuar aplikimet në kuadër të thirrjeve publike dhe ngriti shqetësime për mungesë transparence dhe diskriminim ndaj klubeve të tjera, pasi që disa klube të përzgjedhura kanë përfituar

tashmë mjete të konsiderueshme nga burime të tjera, ndërkohë që shumë klube të vogla mbeten pa mbështetje bazike. Ai tha se kjo formë e ndarjes së subvencioneve përbën keqmenaxhim të buxhetit publik për përfitime politike, e jo për zhvillimin e mirëfilltë të sportit.

Egzon Pacolli: - tha se Kuvendi ka mandat të plotë për të marrë vendime financiare, përfshirë edhe ndarjen e subvencioneve në raste të caktuara, dhe duhet bërë dallim ndërmjet subvencioneve që jepen përmes thirrjeve publike, sipas rregulloreve për financimin e OJQ-ve, dhe vendimeve financiare që janë në kompetencë të Kuvendit Komunal.

Dasmor Durmishi: - ngriti shqetësime për përsëritjen e subvencionimit të klubeve të njëjta, duke theksuar se në Prishtinë ka shumë klube të tjera që meritojnë mbështetje. Ai kërkoi sqarime nga drejtori nëse klubet që kanë përfituar tashmë subvencione apo sponsorizime kanë të drejtë të marrin sërish mjete nga Komuna, dhe gjithashtu propozoi një shpërndarje më të drejtë të subvencioneve dhe vendosjen e rregullave që të përfshihen sa më shumë klube sportive.

Nora Kelmendi: - e pyetë drejtorin e se me cilën rregullore e ka sjell në Kuvend subvencionet. Ajo theksoi se sipas rregullores së vitit 2025 nuk mund të ishin sjellë, pasi thirrja për subvencionim ishte bërë më herët, dhe sipas rregullores së vitit 2018 rekomandimet nga komisioni nuk parashihen të miratohen në Kuvend, pastaj kërkoi sqarim se me cilën rregullore janë paraqitur këto rekomandime për miratim në Kuvend.

Lidhur me pyetjet e parashtruar nga anëtarët e Kuvendit, sqarime të nevojshme dha **Kushtrim Mushica-drejtor**.

Nënkryetari - Shkëmb Manaj: - sqaroi se këto janë ekipe elitare të Prishtinës dhe se zakonisht Kuvendi Komunal ka vendosur për subvencionimin e tyre. Ai theksoi se sipas rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm, financimi i drejtpërdrejtë nga Kuvendi nuk është i ligjshëm, por duhet të zhvillohet një procedurë paraprake nga drejtoria përkatëse dhe për herë të parë, këtë vit është zhvilluar një thirrje publike ku ekipet elitare kanë aplikuar, janë vlerësuar nga një komision profesional dhe rezultatet kanë ardhur në Kuvend për miratim. Manaj theksoi se në të ardhmen mund të mos ketë nevojë që vendimet për subvencionim të vijnë në Kuvend, nëse Kuvendi vlerëson që asnjë subvencion nuk duhet të vijë në Kuvend, por duhet t'i ndajnë drejtuesit përkatës edhe ato mbi 20,000 euro, edhe ato nën 20,000 euro, atëherë jemi në rregull. Ai sqaroi se rregullorja për subvencionet përcakton se ato mbi 20,000 euro duhet të miratohen nga Kuvendi, dhe gjithçka është zhvilluar në përputhje me rekomandimet e auditorit, duke siguruar që asnjë ekip të mos subvencionohet dy herë gjatë të njëjtit vit.

Leonora Shabani: - kërkoi sqarime të qarta se, cilat kritere janë përdorur nga Drejtoria e Sportit për përfshirjen e klubeve në listën e subvencionimit. Ajo theksoi se disa klube në listë janë private ose të ligës së dytë, ndërsa kampionet nuk janë përfshirë në listë për subvencionim.

Betim Abdullahu: - sqaroi se të gjitha klubet aplikojnë çdo vit në thirrjet e hapura të drejtorisë për subvencionim, pa përjashtime. Ai theksoi se disa klube përfshirë klubin "Futball Prishtina", klubi futball "Mabetex Prishtina" dhe klubi i hendbollit për femrave "Prishtina" sepse nuk i kanë marrë mjetet e parapara dhe për këtë kanë të drejtë të aplikojnë për subvencione edhe këtë vit. Abdullahu

nënvizoi se nëse përzgjidhen nga asambleja, ato do të trajtohen si pjesë e subvencionimit të rregullt nga drejtoria.

Gëzim Sveçla: - kritikoi përdorimin e termit “klube elitare” dhe mënyrën se si po trajtohen subvencionet në Kuvend. Ai theksoi se zyra e auditorit nuk i referohet askund një kategorizimi të tillë, duke e konsideruar termin abstrakt dhe problematik për transparencën dhe konkurrencën e drejtë midis OJQ-ve. Sveçla tha se praktika e përsëritur e sjelljes së këtyre klubeve për miratim në Kuvend krijon pasiguri juridike dhe mund të dëmtojë klubet që nuk marrin mjetet e premtuara. Ai propozoi që zgjidhja është një rregullore për shpërblime sportive, që eliminon ndërhyrjen e Kuvendit Komunal dhe i jep kompetencë ekzekutivit për ndarjen e shpërblimeve.

Nënkryetari- Shkëmb Manaj: - theksoi se çështja e subvencioneve lidhet drejtpërdrejt me rregulloren për subvencione, sipas së cilës subvencionet mbi 20,000 euro duhet të miratohen në Kuvend. Ai shtoi se rregullorja aktuale është në fuqi dhe se në të ardhmen nëse Kuvendi e vlerëson, mund të hiqet ky nen, duke bërë që të gjitha subvencionet, pavarësisht shumës, të ndahen përmes thirrjeve publike në përputhje me rregulloret e Ministrisë së Financave dhe të Komunës së Prishtinës, pa nevojën për miratim nga Kuvendi.

Valbona Makolli- drejtore: – bëri një sqarim për Norën se, kodi buxhetor i përdorur nga Drejtoria e Sportit për subvencione i përket vitit 2026, dhe me këtë kod drejtori ka përzgjedhur t’i subvencion projektet e vitit 2025, pasi që mjetet e vitit 2025 janë marrë nga përmbaruesit.

Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për, 9 kundër, 1 abstenim u miratua Vendimi për subvencionimin e “Klubit të Basketbollit të Femrave Prishtina” (KBF Prishtina).

Pika e shtatë:

Propozim - vendimi për subvencionimin e “Klubit të Volejbollit - Prishtina”;

Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për, 10 kundër, 1 abstenim u miratua Vendimi për subvencionimin e “Klubit të Volejbollit – Prishtina”.

Pika e tetë:

Propozim - vendimi për subvencionimin e “Klubit të Basketbollit Sigal Prishtina”;

Kryesuesi konstatoi se më 32 vota për, 10 kundër, 1 abstenim u miratua Vendimi për subvencionimin e “Klubit të Basketbollit Sigal Prishtina”.

Pika e nëntë:

Propozim - vendimi për subvencionimin e “FC Prishtina 01 - Futsall”;

Kryesuesi konstatoi se më 32 vota për, 10 kundër, 1 abstenim u miratua Vendimi për subvencionimin e “FC Prishtina 01 - Futsall”.

Pika e dhjetë:

Propozim - vendimi për subvencionimin e "K.V. Prishtina 75";

Kryesuesi konstatoi se më 29 vota për, 10 kundër, 1 abstenim u miratua Vendimi për subvencionimin e "K.V. Prishtina 75".

Pika e njëmbëdhjetë:

Propozim - vendimi për subvencionimin e "3x3 Prishtina";

Kryesuesi konstatoi se më 31 vota për, 10 kundër, 1 abstenim u miratua Vendimi për subvencionimin e "3x3 Prishtina".

Pika e dymbëdhjetë:

Propozim - vendimi për subvencionimin e "KH Prishtina";

Kryesuesi konstatoi se më 30 vota për, 11 kundër, 1 abstenim u miratua Vendimi për subvencionimin e "KH Prishtina".

Pika e trembëdhjetë:

Propozim-vendimi për subvencionimin e "FC Fucal Mabetex Prishtina";

Kryesuesi konstatoi se më 31 vota për, 10 kundër, 2 abstenim u miratua Vendimi për subvencionimin e "FC Futsall Mabetex Prishtina".

Pika e katërmëdhjetë:

Propozim-vendimi për subvencionimin e klubit të hendbollit "Prishtina femrat";

Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, 11 kundër, 2 abstenim u miratua Vendimi për subvencionimin e klubit të hendbollit "Prishtina" femrat.

Pika e pesëmbëdhjetë:

Propozim-vendimi për lënie në diskutim publik për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores, 01. Nr. 110-2782, më 2.12.2011, për tarifa ngarkesa dhe gjoba komunale;

Arsyeshmërinë për miratimin e këtij propozim-vendimi e paraqiti Luftar Braha- drejtor.

Egzon Pacolli: - tha se gupi i LDK-së e përkrah propozim-vendimin për lënie në diskutim publik për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores, 01. Nr. 110-2782, më 2.12.2011 për tarifa ngarkesa dhe gjoba komunale.

Leutrim Retkoceri: - tha se e mbështetë në parim nxjerrjen e rregullores në diskutim publik. Ai falënderoi drejtorin për arsyetimet dhe theksoi se, gjatë dëgjimit publik pritet që rregullorja të

pasurohet me rekomandime nga qytetarët, për t'u kthyer më pas për votim me sugjerimet përfundimtare.

Nexhmije Gjema: - ajo ngriti shqetësime lidhur me propozimin për taksa fikse ndaj bizneseve, duke theksuar se ato nuk marrin parasysh fitimin, madhësinë apo kapacitetin ekonomik dhe krijojnë barrë të padrejtë, sidomos për bizneset e vogla, dhe tha se në praktikën evropiane taksat bazohen në fitim ose shërbime konkrete, jo thjesht në ekzistencën e biznesit, dhe paralajmëroi se këto masa mund të çojnë në rritje çmimesh dhe largim të bizneseve nga Prishtina. Ajo kritikoi strukturën e tarifave komunale, duke e cilësuar si të pabalancuar dhe me trajtim të pabarabartë ndërmjet sektorëve të ndryshëm. Ku një shqetësim i veçantë u ngrit për propozimin e taksës për hyrje në kryeqytet, i cili u konsiderua i paqartë dhe i papraktikuar në rajon dhe në shumicën e qyteteve evropiane, ku tarifat aplikohen vetëm për zona të caktuara dhe jo për gjithë territorin. Nexhmija theksoi se, kjo masë do të krijojë barrë të madhe për qytetarët, bizneset dhe furnizuesit, duke ndikuar negativisht në ekonomi dhe jetën sociale, ndërsa ngriti dyshime se qëllimi i saj mund të jetë më shumë gjenerimi i të hyrave sesa menaxhimi i trafikut.

Sokol Havolli - drejtor: - ai ngriti shqetësimin për dëmtimin e infrastrukturës rrugore si pasojë e ndërhyrjeve nga qytetarët dhe operatorët, veçanërisht nga ujësjellësi, duke theksuar se rrugët shpesh nuk sanohen me kohë dhe cilësia e tyre degradohet. Ai propozoi që përgjegjësia për hapjen dhe sanimin e rrugëve të kalojë tek komuna, ndërsa operatorët të paguajnë tarifa më të larta për të mbuluar kostot reale të rikuperimit. Havolli kërkoi trajtim më të qartë të çështjes së kanalizimeve, duke theksuar se ndërkohë që komuna investon në ndërtimin dhe sanim të rrjetit, ujësjellësi përfiton të hyrat nga qytetarët dhe duhet të mbajë përgjegjësi më të madhe për mirëmbajtjen dhe riparimet. Ai nënvizoi nevojën për ndryshime në rregullore ose hartimin e një rregulloreje të veçantë për të shmangur dëmet financiare të larta ndaj komunës.

Luftar Braha: - thekson se synimi nuk është largimi i bizneseve nga Prishtina, por krijimi i kushteve më të mira për zhvillimin e tyre, duke ofruar siguri dhe ambient më të përshtatshëm pune. Ai nënvizon se bizneset duhet të kontribuojnë përmes tarifave për shërbimet komunale që përdorin. Z. Braha tha se ndërhyrjet infrastrukturore janë paraparë në fazën fillestare, por mund të avancohen më tej, duke përfshirë tarifimin e kompanive që kryejnë punime dhe vendosjen e detyrueshme të sigurimit të ekzekutimit për çdo ndërhyrje në infrastrukturë.

Gëzim Sveçla: – theksoi se Lëvizja Vetëvendosje shpreh mbështetje që rregullorja të kalojë në dëgjim publik, pavarësisht një numri të madh vërejtjesh në draftin fillestar. Ai vlerëson se ekziston një kufi i ndjeshëm mes pagesës për shërbime dhe sanksioneve të mundshme ndaj qytetarëve dhe bizneseve, i cili duhet trajtuar me kujdes, në këtë kontekst, theksohen disa shqetësime konkrete: vendosja e taksës së akomodimit për qytetarët që nuk janë të Prishtinës, tarifa prej 10 euro për automjete, pa pasur alternativa të mjaftueshme të transportit publik, si dhe kapacitetet e kufizuara të trafikut urban për të përballuar kërkesën. Sveçla ngriti shqetësim se tarifat për biznese, si ato për pompat e derivateve, mund të reflektohen në rritjen e çmimeve për qytetarët, dhe theksoi se ka nevojë për kujdes të shtuar gjatë hartimit të rregullores, ndërsa vërejtjet dhe propozimet do të paraqiten në fazat e mëtejme të procedurës.

Jeton Mehmeti - thekson nevojën për koordinim më të mirë brenda administratës komunale para se draftet të paraqiten në Kuvend, si dhe kërkon përfshirjen e zyrës ligjore për të siguruar përputhshmërinë me ligjin. Ai shprehet në parim pro dërgimit të rregullores në dëgjim publik, por vetëm pas një analize më të thellë dhe përmirësimeve të nevojshme, sepse drafti aktual paraqet probleme serioze juridike dhe bie ndesh me ligjet që rregullojnë kompetencat financiare të komunave. Ai veçon disa çështje kryesore: një nen që parasheh tarifë për automjetet që janë të regjistruara jashtë kryeqytetit, i cili konsiderohet diskriminues dhe në kundërshtim me parimin e barazisë, kategorizimin e bizneseve në bazë të zonës urbane, rurale, që nuk lejohet nga ligji si dhe kundërthënie në dispozita që lidhen me licencimin dhe sanksionimin e bizneseve. Ai vlerëson se rregullorja duhet të rikthehet për rishikim të plotë juridik, pasi disa dispozita tejkalojnë autorizimet ligjore, përdorin kritere të ndaluara dhe rrezikojnë liritë ekonomike dhe sigurinë juridike.

Feim Osmani - thekson rëndësinë e rregullores dhe mbështet dërgimin e saj në dëgjim publik, duke paralajmëruar se do të japë komente shtesë gjatë procesit. Ai kërkon nga institucionet më shumë angazhim në informimin e qytetarëve, pasi pjesëmarrja në dëgjimet publike ka qenë e ulët, dhe sugjeron përdorimin e mediave dhe njoftimeve publike për të rritur përfshirjen.

Kryesuesi konstatoi se me 38 vota për, asnjë kundër, 1 abstenim u miratua Vendimi për vënie në diskutim publik për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores, 01. Nr. 110-2782, më 2.12.2011 për tarifa ngarkesa dhe gjoba komunale.

Kryesuesi - pas një konsultimi me të pranishmit në sallë u pajtuan që pika 16 dhe 17 të diskutohen së bashku pasi që të dy pikat kanë të bëjnë me financat.

Pika gjashtëmbëdhjetë

Raporti financiar buxhetor i kryeqytetit, për periudhën 1 tetor – 31 dhjetor 2025 (TM4)

Pika shtatëmbëdhjetë

Raporti financiar buxhetor i kryeqytetit, për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2025

Lidhur me Raportin financiar buxhetor të kryeqytetit për periudhën 1 tetor – 31 dhjetor 2025 (TM4) dhe Raportin financiar buxhetor të kryeqytetit për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2025, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi **Valbona Makolli - drejtore**.

Leutrim Retkoceri: - vlerëson se gjendja financiare e Prishtinës mbetet sfiduese, me paqartësi në realizimin e projekteve dhe vonesa në shlyerjen e obligimeve ndaj operatorëve privatë. Ai theksoi mungesën e të dhënave të plota në raport, veçanërisht për çështjet përmbartimore, si aspektet juridike dhe kostoja financiare që i kanoset komunës. Retkoceri ngriti shqetësime për barrën financiare që mund të vazhdojë edhe në vitin pasues dhe kërkon sqarime rreth mundësisë së rishikimit të buxhetit nga niveli qendror. Ai nënvizoi nevojën për më shumë transparencë në raportim, sidomos për projektet e paraqitura si të realizuara, por që në praktikë mund të mos kenë filluar ende.

Feim Osmani - e cilësoi raportin buxhetor si më të dobët, duke kritikuar menaxhimin e financave në Prishtinë. Ai theksoi se, pavarësisht buxhetit të lartë, shpenzimet nuk kanë sjellë përmirësime reale për qytetarët, ndërsa të hyrat mbeten të ulëta dhe varësia nga grantet vazhdon. Osmani ngriti

shqetësime serioze për mungesë transparence dhe pasaktësi në raportim, sidomos për shpenzimet kapitale dhe projektet që raportohen si të realizuara, por në praktikë nuk kanë filluar. Gjithashtu, kritikoi rritjen e shpenzimeve për paga dhe subvencione, duke i lidhur me keqmenaxhim dhe ndikime politike. Ai theksoi problemin e madh të përmbarimeve, ku shuma të konsiderueshme nga buxheti janë ekzekutuar përmes përmbaruesve, duke ngritur dyshime për keqpërdorim dhe duke kërkuar hetim institucional. Feimi e konsideron realizimin e buxhetit si skandaloz dhe kërkon llogaridhënie nga ekzekutivi komunal.

Besa Shahini: - kritikon ashpër menaxhimin e buxhetit në Prishtinë, duke theksuar se një pjesë shumë e madhe e tij është shpenzuar përmes përmbaruesve, çka sipas saj përbën mënyrën më të dëmshme të shpenzimit dhe një humbje direkte të buxhetit. Ajo vlerëson se përgjegjësia kryesore bie mbi ekzekutivin komunal, duke përmendur mungesën e kordinimit politik dhe dështimin për miratimin me kohë të buxhetit. Besa theksoi se një pjesë e kostove lidhet me obligimet nga kontrata kolektive, por menaxhimi i dobët ka rritur barrën financiare, dhe ngre shqetësime për mungesë transparence në shpenzime, sidomos në sektorë si menaxhimi i mbeturinave, dhe kërkon llogaridhënie nga udhëheqja komunale për keqmenaxhimin e buxhetit.

Fjolla Vukshinaj: - vlerëson rritjen e të hyrave vetanake dhe përmirësimin e transparencës në Prishtinë, por thekson nevojën për përmirësim të raportimit financiar. Ajo ngriti shqetësimin për rritjen e madhe të pagesave përmbarimore, duke theksuar se një pjesë e konsiderueshme e buxhetit kapital ka shkuar në këto pagesa dhe propozon që raportet të jenë më të detajuara dhe më të strukturuar, duke përfshirë ndarje më të qarta të shpenzimeve, evidencë të projekteve (p.sh. përmes fotografive) dhe përdorim më të madh të fusnotave për sqarime shtesë. Ajo thekson se këto ndryshime do të rrisnin transparencën dhe do ta bënin raportin më të kuptueshëm për qytetarët dhe vendimmarrësit.

Nora Kelmendi: - ngriti shqetësime lidhur me menaxhimin financiar dhe realizimin e të hyrave të Komunës së Prishtinës, sipas të dhënave të vitit 2025, shpenzimet komunale janë rritur më shpejt se të hyrat, gjë që sipas saj krijon presion fiskal dhe rrezik për stabilitetin buxhetor. Ajo tha se ka rënie të konsiderueshme në disa kategori të të hyrave, përfshirë taksën për shfrytëzimin e hapësirës publike, licencat e bizneseve dhe të hyrat nga qiratë e banesave, duke ngritur dyshime për mosrealizim të obligimeve financiare dhe mungesë të kontrollit institucional. Nora kritikoi pasaktësi dhe përsëritje të shifrave në raportet buxhetore për vite të ndryshme, duke e cilësuar këtë si tregues të planifikimit të dobët dhe dështim në zbatimin e projekteve infrastrukturore. Ajo tha se situata nuk përbën vetëm dobësi menaxheriale, por edhe një dështim më të gjerë politik, duke kërkuar transparencë më të madhe, llogaridhënie dhe përdorim më efikas të të hyrave publike në dobi të qytetarëve.

Ilirik Musliu: - potencoi sfidat financiare të Komunës së Prishtinës për vitin 2025 dhe kërkoi sqarime mbi tri çështje: Sa është vlera e faturave të papaguara për projektet e përfunduara që ende nuk kanë kaluar në përmbarim, sa është shuma totale e lëndëve që janë në procedurë përmbarimore si pasojë e vonesave në pagesa dhe sa janë obligimet e papaguara ndaj ndërmarrjeve lokale, duke theksuar se këto vonesa po dëmtojnë cilësinë e shërbimeve dhe po rrezikojnë pagat e punëtorëve. Ai kërkoi hartimin e një plani të veprimit për të stabilizuar gjendjen buxhetore dhe për të evituar ciklin e borxheve që pengojnë projektet afatgjate.

Gëzim Sveçla: - ngriti një shqetësim lidhur me mënyrën e udhëheqjes së seancës. Ai kritikoi sjelljen e drejtuesit, duke e cilësuar atë si keqpërdorim të pozitës dhe kërkoi që asamblistëve të Lëvizjes Vetëvendosje, konkretisht Feim Osmanit, t'i garantohet e drejta e fjalës si përfaqësues i qytetarëve.

Feim Osmani: - kritikoi ashpër menaxhimin financiar të komunës, duke u fokusuar në shpenzimin e rreth gjysmës së buxhetit prej 158 milionë euro përmes përmbaruesve. Ai hodhi poshtë pretendimet se mosvotimi i buxhetit ka shkaktuar bllokadë, duke sqaruar se ligji lejonte shpenzimin e mbi 9 milionë eurove në muaj (1/12 e buxhetit). Z. Osmani akuzoi ekzekutivin për mungesë transparencë në raportimin e projekteve që kanë përfunduar në përmbarim dhe për manipulim me shifra. Ai kërkoi llogari se pse kontratat e vitit 2024 nuk janë paguar me kohë, pavarësisht mjeteve të inkasuara dhe shprehu keqardhje për mungesën e udhëheqjes së komunës gjatë këtij diskutimi.

Lidhur me vërejtet dhe sugjerimet e dhëna nga anëtarët e Kuvendit, sqarime të nevojshme dha **Valbona Makolli - drejtore.**

Sokol Havolli: - ai sqaroi se mbledhja e mjeteve në vitin 2025 u rrit kryesisht nga arkëtimi i borxheve të prapambetura nga qytetarët dhe jo nga faturimi i ri, ndërsa nga licencat e veprimtarive afariste, tregoi rritjen e faturimit nga 94,600 euro (në vitin 2021) në mbi 167,000 euro (në vitin 2025), me rregulloret e reja, ajo parashikon që këto të hyra të arrijnë deri në 2 milionë euro.

Pika e tetëmbëdhjetë

Propozim-vendim për plotësim ndryshim të PRR Muhaxhirët, blloku d-01 për nevojat e Fakultetit të Arkitekturës.

Arsyeshmërinë për miratimin e këtij propozim-vendimi e paraqiti **Arbër Sadiki - drejtor.**

Egzon Pacolli: - deklaroi se e mbështesin si Propozim-vendimin lidhur me plotësim-ndryshimin e planit për Muhaxhirë, blloku 2.0. Ai specifikoi se ky ndryshim bëhet për të mundësuar zgjerimin e Fakultetit të Arkitekturës dhe ftoi grupet e tjera parlamentare që ta përkrahin këtë nismë.

Nora Kelmendi: - ajo propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të tërhiqet, pasi mungon dokumentacioni i nevojshëm shoqërues. Aktualisht kemi vetëm një vendim, pa analiza, projekte të detajuara dhe pa vlerësim të ndikimeve. Ajo tha se ne si asamblistë, nuk mund të marrim vendime pa material të plotë, pasi kjo bie ndesh me parimet e transparencës dhe përgjegjësisë institucionale. Nora kërkoi që kjo pikë të rikthehet për shqyrtim pasi të plotësohet dokumentacioni i nevojshëm.

Besa Shahini: - tha se e mbështes kërkesën e Fakultetit të Arkitekturës, por nuk mund të votojmë pa asnjë dokument përcjellës. Ju lutem ta trajtoni me më shumë seriozitet asamblenë komunale kur kërkon votën tonë.

Jeton Mehmeti: - deklaroi se e mbështet këtë propozim për shkak të interesit publik dhe rëndësisë për Fakultetin e Arkitekturës, por nuk e kam të qartë pse dokumentacioni dhe skicat nuk janë dorëzuar me kohë. Ai tha nëse çështja është kaq urgjente, pse nuk është ndarë materiali paraprakisht që ta shqyrtojmë dhe ta votojmë me konsensus dhe luti që t'i jepet një arsye e thjeshtë për këtë vonesë.

Arbër Sadiki: - tha se materialin e kam dorëzuar brenda afatit kohor si obligim i drejtorisë dhe nuk kam informacion pse nuk është përfshirë në rendin e ditës apo pse nuk është shpërndarë te të gjithë. Ai tha se nëse ju ndihmon, mund ta paraqes shkurtimisht materialin dhe propozimin me një prezantim prej 2-3 minutash.

Gëzim Sveçla: - tha se kjo situatë është shqetësuese, nëse materiali është dorëzuar me kohë, pse kjo pikë nuk është përfshirë në rendin e ditës?. Ai kërkoi sqarime të qarta nga ekzekutivi, pasi mungesa e komunikimit dhe koordinimit brenda ekzekutivit po pengon vendimmarrjen e duhur në asamble.

Jeton Mehmeti: - tha se është shqetësuese mungesa e kordinimit brenda administratës, pasi po sjell përsëritje të propozimeve dhe humbje kohe në Kuvend, ku në kushte normale, këto çështje duhet të jenë të harmonizuara paraprakisht, me konsultime të brendshme dhe me opinion ligjor, para se të sillen në Kuvend për votim. Ai shpreson që në të ardhmen të ketë më shumë organizim dhe komunikim të brendshëm, në mënyrë që proceset të jenë më efikase.

Kryesuesi konstatoi se me 28 vota për, 1 kundër, 1 abstenim u miratua Vendimi për plotësim ndryshim të PRR Muhaxhirët, blloku d-01 për nevojat e Fakultetit të Arkitekturës.

Pika e nëntëmbëdhjetë

Propozim-vendim për ndërrim të destinimit nga banim individual në institucion arsimor privat në kuadër të planit rregullues të hollësishëm Mati 3.

Arsyeshmërinë për miratimin e këtij propozim-vendimi e paraqiti **Arbër Sadiki - drejtor.**

Besianë Musmurati: - pyeti drejtorin se a ekziston ndonjë program apo plan që përfshin edhe fëmijët që nuk paguajnë kursin siç janë nxënësit e shkollave publike konkretisht shkolla "Mitrush Kuteli" që edhe ata të përfitojnë nga shërbimet e shkollës digjitale duke bashkëpunuar ne mes veti.

Gëzim Sveçla: - pyeti drejtorin se a ka ndodhur më parë që Kuvendi komunal të ndryshojë destinimin e një objekti dhe a ekziston rreziku që kjo të krijojë precedent që çdo kërkesë e tillë të vijë në Kuvend, dhe pse në këtë rast kjo çështje po trajtohet nga Kuvendi dhe jo nga Drejtoria e Urbanizmit, nëse nuk ka ndryshime thelbësore në plan. Ai pyeti se cili është interesi publik që kjo çështje po sillet në Kuvend dhe a po krijojmë një praktikë që mund të hapë rrugë për kërkesa të ngjashme edhe në të ardhmen.

Lidhur me pytjet e bëra nga anëtarët e Kuvendit, sqarime të nevojshme dha **Arbër Sadiki - drejtor.**

Fadil Aliu: - tha se plani rregullativ, pasi miratohet nga Kuvendi komunal, përcakton zonat e ndryshme si banimi, ekonomike dhe gjelbërimi, dhe bëhet bazë ligjore për zhvillimin urban. Ai tha se çdo leje ndërtimi duhet të jetë në përputhje me këtë plan, dhe çdo devijim prej tij përbën shkelje të rregullave dhe çdo ndryshim i destinimit të tokës që nuk është në përputhje me planin e miratuar duhet të kthehet sërish në Kuvend për votim, pasi përgjegjësia për ndryshime të tilla i takon këtij organi. Aliu e konsideroi të domosdoshme që çdo ndryshim i planit të trajtohet dhe miratohet në Kuvend.

Nora Kelmendi: - shpreh qëndrimin se çdo ndryshim i planeve rregulluese duhet të sillet në Kuvend për miratim dhe njëkohësisht, theksoi rëndësinë e përfshirjes së qytetarëve në proces. Ajo konsideroi se në rastet kur bëhen ndryshime të planeve ose pjesëve të tyre, duhet të zhvillohet dëgjim publik, në mënyrë që qytetarët të informohen dhe të kenë mundësi të kontribuojnë me vërejtje dhe propozimet e tyre.

Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për, 1 kundër, 1 abstenim u miratua Vendimi për ndërrim të destinimit nga banim individual në institucion arsimor privat në kuadër të Planit rregullues të hollësishëm Mati 3.

Pika e njëzetë

Pyetje dhe përgjigje

Nexhmije Gjema për ekzekutivin

- Pyeti për ndalim qarkullimin e mjeteve bujqësore (traktor) në kryeqytet, pa ju caktuar një orar për qarkullim pasi që nuk ka rrugë alternative dhe kjo krijon vështirësi për ta, ndërsa kamionët e ndërtimit vazhdojnë të qarkullojnë lirshëm dhe të shkaktojnë dëme në infrastrukturë dhe rrezik në komunikacion, dhe kalojnë pa kontrolle dhe ndëshkim të mjaftueshëm.
- Pyetja e dytë ka të bëjë me vendimin për ndalimin e punimeve në sektorin e ndërtimit në gjithë komunën, duke e cilësuar si masë kolektive që prek edhe kompanitë që veprojnë në përputhje me rregullat dhe kanë obligime kontraktuale. Ajo vlerësoi se një qasje e tillë nuk është e drejtë dhe nuk e zgjidh problemin, por vetëm e zhvendos barrën te subjektet që nuk janë përgjegjëse për dështimet institucionale, duke theksuar nevojën për adresim të përgjegjësisë individuale dhe forcim të kontrollit institucional.

Lidhur me pyetjen e parë të parashtruar nga z. Gjema, përgjigje dha **Luftar Braha - drejtor**.

Enver Redenica, për drejtoreshën e Drejtorisë së Parqeve, drejtorin e drejtorisë së Pronës dhe drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit, drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale:

- A ka leje ky minirestorant aty, nëse po, të bëhet publike që të dimë se në bazë të cilës rregullore, cilit nen e keni lëshuar lejen.
- Pyetja për drejtorin Sokol Havolli - kanalizimi fekal te Shkolla Normale është një problem i madh, sipas ish - drejtorit të investimeve kapitale, z. Krenar Xhaferi, ky kanalizim është dashur të përfundojë në vitin 2023, por nuk ka përfunduar. Kryetari, më 10 qershor 2025 ka premtuar që do të jetë prioritet për vitin 2026 dhe nuk është ndarë asnjë cent. A pritet që komuna të marrë ndonjë veprim lidhur me këtë.
- Kryetarët e këshillave lokal nuk kanë marrë pagë që 15 muaj, dhe nuk kanë as kushte minimale të punës. Në emër të grupit të LVV-së kërkoi të hartohet një rregullore dhe të sillet në Kuvend për rritje të pagave të kryetarëve të këshillave lokal.

Besart Krasniqi, për drejtorin e Drejtorisë së Emergjencave, drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Kërkesë nga banorët e lagjes “Kodra e Trimave”, Rr. “Arina Tasi”, “Besnik Lajçi”, “Danijel Defo” kanë nevojë të asfaltohen dhe instalohet rrjeti i ndriçimit për shkak se ato mungojnë me vite, në fshatin Bardhosh në Rr. “Beqir Jakupi”, “Velipoja”, “Qazim Billaca” ka probleme me kanalizim, mbeturina, ndriçim, rrugë dhe me qentë endacakë në Bërnice të Epërme ka nevojë të asfaltohet rr. Shaban Manaj, kurse rr. Vjosa në Bërnice të Poshtme ka nevojë për ndriçim.
- Në lagjen “Lakërishte”, Rr. “Viktor Majer” në objektin banesor në hyrjen e tretë është dëmtuar shumë objekti.
- Në banesat e veteranëve dhe socialit në fushën e pajtimit banorët ankohen se deri më tani kanë pasur një hapësirë për parking të veturave, por e njëjta hapësirë nuk lejohet më të shfrytëzohet nga banorët dhe ata kërkojnë një zgjidhje në mënyrë që të kenë mundësi të parkojnë veturat e tyre.
- Në lagjen “Dardania” të “Kroi i Bardhë”, në fushën e sportit, mungon ndriçimi tash e një muaj, ku po paraqet problem për banorët, pasi që gjatë mbrëmjes nuk mund të shfrytëzohet kjo fushë sportive nga banorët e lagjes.

Feim Osmani: - tha se mungesa e vazhdueshme e kryetarit dhe drejtorëve në pikën e pyetjeve dhe përgjigje dhe të ndyshme në Kuvendin komunal, tregon mungesë serioziteti ndaj shqetësimeve të qytetarëve dhe punës së asamblistëve dhe si rezultat i kësaj propozoi që këto pika të hiqen fare nga rendi i ditës, pasi po konsiderohet humbje kohe.

Besa Shahini, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- A po përdoret hapësira e përkohshme për grumbullimin e mbeturinave inerte edhe vëllimore, a po funksionon ky sistemi ku duhet të kontaktohet kompania e gjelbërt që ata ta bëjnë bartjen, a po i çojnë qytetarët edhe vet atje pa lejen tuaj edhe çka është një plan ndoshta për promovimin më të madh të kësaj hapësire, në mënyrë që gjithë qytetarët të jenë të informuar se ku mund t'i hedhin këto mbeturina.

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga z. Shahini, përgjigje dha **Luftar Braha - drejtor.**

Leonora Shabani-Bajraktari, për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë, drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, drejtorin e Drejtorisë së Mobilitetit:

- Niveli qendror ka ndarë buxhet për intervenimin e hershëm, ku do të ofrohen në katër qendra të mjekësisë familjare, logopedi, psikologu, fizioterapeuti edhe punëtori social, a ka filluar Drejtoria e Shëndetësisë parapërgatitjet dhe kur do të fillojë në Komunën e Prishtinës ky shërbim t'u ofrohet fëmijëve me nevoja të veçanta.
- Rr. Malush-Kosova nuk ka trotuare, nuk ka ndriçim, është një rrugë e gjatë dhe nuk ka transport publik.
- A do të fillojë ndërtimi i urës në fshatin Slivovë.

Lidhur me pyetjen e parë të parashtruar nga z. Leonora, përgjigje dha **Izet Sadiku - drejtor.**

Lidhur me pyetjen e parashtruar për transportin publik përgjigje dha **Donat Lushaku - drejtor.**

Gëzim Sveçla, për drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit

- Pyetja ka të bëjë me rastin e të dielës, shembjen e rrugës në lagjen “Prishtinë e Re”, prandaj kërkoi sqarim lidhur me formimin e quajtur kolegji profesional, një organ i jashtëligjshëm i formuar që sa kohe prej Kryetarit Rama përmes të cilit kalojnë të gjitha lejet ndërtimore dhe të gjitha projektet. Pyetja kishte me qenë se cilat kanë qenë kushtet ndërtimore që janë lëshu në atë rast, kur ne e pamë aty një gjendje të tmerrshme, kur është gropuar thuhet edhe nën rrugë.
- drejtorin e inspeksionit, me e pyet për formimin e komisionit për rastin e lartëcekur se cilat janë kompetencat e këtij komisioni.

Jeta Dida Bujari për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike

- Kërkoi sqarim të plotë lidhur me Vendimin e Komunës së Prishtinës për caktimin e një lokacioni për deponinë e mbeturinave inerte dhe vëllimore në një hapësirë që ndodhet pranë zonave të gjelbra dhe natyrore të kryeqytetit në rrugën “Qëndresa”. Ekziston shqetësimi se kjo hapësirë mund të funksionojë vetëm si pikë grumbullimi pa një sistem të strukturuar ndarje dhe riciklimi, në këtë kontekst, kërkohet sqarim mbi kriteret e përzgjedhjes së lokacionit dhe alternativat e mbi mënyrën e ndarjes dhe trajtimit të mbeturinave, mbi operatorët përgjegjës për reciklimin dhe trajtimin final, si dhe mbi mekanizmat e monitorimit dhe mbrojtjes mjedisore.

Lidhur me sqarimet e kërkuara nga z. Dida Bujari përgjigje dha **Luftar Braha - drejtor.**

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga Z. Sveçla, Z. Redenica dhe Z. Nexhmije, përgjigje dha **Bekim Brestovci, drejtor.**

Jeton Mehmeti, për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit:

- Pse ka kaq pak inspektorë në drejtorinë tuaj dhe ata inspektorë që janë sa janë aktiv dhe sa kanë kapacitete me i mbikëqyr këto vendpunishte.
- Sa është distanca mes infrastrukturës kritike dhe vendosjes së aktiviteteve të punës apo të punishteve për vendosjen e shtyllave mbrojtës apo pilotat mbrojtës që mos me i rreziku jetën e punëtorëve, pastaj komplet furnizimin e një pjese të madhe të qytetit që është me energji elektrike, me ujësjellës edhe me gjëra tjera.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga Z. Mehmeti përgjigje dha **Bekim Brestovci - drejtor.**

Leonora Shabani-Bajraktari, për drejtoren e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale:

- gratë pensionere i kanë dy-tri shoqata siç janë: Organizata “Vita-Jeta”, Organizata “Pojata” dhe disa organizata tjera, që bëjnë aktivitet dyditor gjatë javës, të martën dhe të enjtën mblidhen dhe bëjnë punime dore, dhe disa gjëra tjera, por ambienti është shumë i ftohtë dhe ngrohen me disa kaloriferë. A ka në plan komuna që të vendosë të paktën nga një kondicioner për ngrohje.

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga z. Leonora përgjigje dha **Adelina Sahiti - drejtore.**

Jeta Dida Bujari, për drejtoren e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale:

Jeta thekson rëndësinë e forcimit të shërbimeve sociale në Prishtinë, duke vënë në fokus nevojën urgjente për mbështetje më të madhe ndaj qytetarëve në nevojë. Qendrat për Punë Sociale përballen me rritje të rasteve komplekse, ndërsa kapacitetet e tyre mbeten të kufizuara, prandaj kërkohet zgjerim i stafit profesional, menaxhim më i mirë i shërbimeve dhe investim në zhvillimin dhe mirëqenien e punonjësve socialë. Shërbimet sociale duhet të kalojnë nga reagimi ndaj krizave në parandalimin e tyre.

Ajo tha se mënyra se si kujdesemi për më të ndjeshmit ndër ne, tregon qartë se kush jemi si shoqëri.

Mbledhja përfundoi në orën 17:03

Procesmbajtësi
Skender Tora

Kryesues i Kuvendit
Fehmi Kupina

